



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Letërsi e Gjuhës B (1)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore, 20 leksione, 20 seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon mësimin e letërsisë turke nëpërmjet një metode të njohur. Lënda është e organizuar në seminare dhe lekione dhe shërben si praktikë për të zhvilluar kompetencat gjuhësore të studentëve. Përdorimi dhe zbatimi i teorisë së strukturave gjuhësore në praktikë do të jenë qenësore, brenda dhe jashtë një konteksti të caktuar, thelbësore këto për procesin e mësimdhënies dhe të përkthimit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Ky kurs do të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha konceptet themelore të letërsisë turke;
2. Pjesët e ligjëratis dhe tipat e ndryshëm stilistikë të fjalëve, bashkë me nën-kategorizimin e tyre;

Rezultatet e pritshme:

1. Njohë dhe analizojë konceptet themelore të letërsisë turke, duke përvetësuar nocione kryesore teorike dhe historike.
2. Identifikojë dhe interpretojë pjesë të ndryshme të ligjëratis dhe stileve gjuhësore, si dhe të bëjë nën-kategorizimin e tyre sipas kriterëve stilistike dhe funksionale.
3. Zbatojë strukturat gjuhësore të mësuara në kontekste të ndryshme, si në analizën letrare, ashtu edhe në ushtrime praktike të përkthimit dhe komunikimit.
4. Zhvillojë kompetencat gjuhësore përmes leximit, diskutimit dhe interpretimit të teksteve letrare, duke ndërtuar një qasje të pavarur dhe analitike ndaj veprave të përzgjedhura.